



SESIONI PRANVEROR I KUVENDIT TË KOSOVËS

LIGJVËNIA MES SHUMË SFIDAVE

16 janar - 28 korrik 2023





Instituti Demokratik i Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2023. Kosovo Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Autorë: **Violeta Haxholli dhe Arbër Thaçi**

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org



Kingdom of the Netherlands

Layout and design: **envinion**

Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Zgjerimi i hapësirës qytetare për reformën në drejtësi", i financuar nga Ambasada Holandeze në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Holandeze në Prishtinë.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE - 6

ZHVILLIMET NË SEANCA? - 7

Planifikimi dhe mbarëvajtja - 7

Mungesa e kuorumit - 9

Përdorimi i gjuhës jo parlamentare - 11

Funksioni Mbikëqyrës - 12

SI U TRAJTUA REFORMA NË DREJTËSI? - 15

Fillimi i sesionit pranveror me Ligjin për Byronë? - 15

Konsensusi politik për zhvillimin e Vetingut në Drejtësi - 15

Polemikat rreth Ligjit për Këshillin Prokurorial - 16

ZHVILLIMET NË KOMISIONE - 17

HAPA MBRAPA NË TRANSPARENCË - 22

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME - 24



HYRJJE

Ky raport analitik vlerëson sesionin pranveror të Kuvendit të Kosovës të këtij viti, nga fillimi me 16 janar deri në përfundim të tij me 28 korrik.

Raporti është rezultat i monitorimit sistematik të KDI-së, përmes monitorimit fizik dhe elektronik të punimeve të Kuvendit.

Pjesa e parë e raportit ofron një pasqyrë të gjerë të zhvillimeve në seanca të Kuvendit, me fokus në trajtimin e projektligjeve, temat që mbizotëruan këtë sesion, mungesat e deputetëve, sjelljen e tyre në seanca, rolin mbikëqyrës ndaj ekzekutivit dhe përgjegjshmërinë e këtyre të fundit ndaj Kuvendit.

Në pjesën e dytë të raportit trajtohet puna e Komisioneve parlamentare veç e veç, duke pasqyruar mbarëvajtjen e punës në komisione, shqyrtimin e projektligjeve, vizitat në terren, raportimet e ekzekutivit dhe çështje tjera që bien në fushëveprimin e Komisioneve.

Përveç këtyre, raporti përfshin edhe dy seksione të veçanta, atë për Reformën në Drejtësi dhe për nivelin e transparencës së Kuvendit karshi publikut. Seksioni për Reformën në Drejtësi trajton mënyrën se si Kuvendi e ka adresuar këtë proces, numrin e ligjeve që janë miratuar dhe elemente tjera që e kanë karakterizuar shqyrtimin e ligjeve që bien në kuadër të Reformës. Ndërsa, seksioni për transparencën e Kuvendit, trajton çështjen e votimit në seanca dhe publikimin e dokumenteve nga ana e Kuvendit.

Në fund, raporti ofron edhe konkluzionet dhe rekomandimet për Kuvendin dhe deputetët, për të adresuar mangësitë që e kanë shoqëruar këtë sesion pranveror dhe jo vetëm, e të cilat nuk do të duhej të përsëriteshin në sesionet e ardhshme.



ZHVILLIMET NË SEANCA

Planifikimi dhe mbarëvajtja

Kuvendi gjatë sesionit pranveror të këtij viti ka organizuar në tërësi 49 seanca. Në pikëpamje numerike, këto seanca paraqesin një të dhënë mjaftueshëm të kënaqshme që sesioni të mund të vlerësohej si i suksesshëm, mirëpo shpërfaqja e problemeve dhe sfidave të zakonshme të Kuvendit përgjatë punës parlamentare, kanë bërë që puna e këtij sesioni të mos jetë shumë efektive dhe rezultatet të jenë të pamjaftueshme (Tabela 1.1). Nga këto seanca, afërsisht gjysma e tyre ishin mbledhje plenare, ndërsa ngecja në trajtimin e agjendës parlamentare në vitin paraprak e aktual dhe keqplanifikimi, shkaktoi nevojën për mbajtjen e një numri të madh të vazhdimeve të seancave. Përveç tyre, u mbajtën edhe tetë seanca të jashtëzakonshme dhe dy tjera të karakterit solemn.

Tabela 1.1 Seancat e Kuvendit gjatë sesionit pranveror

Seanca Plenare	22
Vazhdime të Seancave	17
Seanca Solemne	2
Seanca të Jashtëzakonshme	8
GJITHSEJ:	49

Gjatë këtij sesioni, Kuvendi ka miratuar gjithsej 44 projektligje. Nga këto, 17 projektligje ishin pjesë e planit legjislativ të Qeverisë 2023. Një numër i konsiderueshëm i projektligjeve të miratuara, janë marrëveshje ndërkombëtare, gjithsej 11 prej tyre, ndërsa vetëm 7 projektligje, janë projektligje të draftuara që i takojnë përmbajtjes së agjendës së ekzekutivit. Për nga fushëveprimtaria, ligjet e miratuara mbulojnë një fushë të gjerë - duke filluar nga projektligje që prekin fushën e drejtësisë, konkretisht Reformën në Drejtësi, sikurse Byroja për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Projektligji për Prokurorin e Shtetit etj. Më tutje, nga fusha e administrimit të zgjedhjeve, Projektligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, nga Bujqësia, Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, nga iniciativat rajonale, Ligji për Zhvillimin Rajonal etj. Në tabelën e mëposhtme (2.1) janë disa nga Ligjet e miratuara nga Kuvendi gjatë këtij sesioni, të dalluara qoftë për nga rëndësia apo fushëveprimtaria që ato përfshijnë.

Në anën tjetër **14 projektligje arritën të miratoheshin vetëm në shqyrtim të parë dhe ende presin dritën e gjelbër nga ana e deputetëve për miratim në lexim të dytë.** Ndër ta, edhe Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, miratimi i të cilit paraqet nevojë urgjente, duke pasur parasysh situatën faktike në vend.





Kuvendi ka miratuar gjithsej 44 projektligje. Nga këto, 17 projektligje ishin pjesë e planit legjislativ të Qeverisë 2023, duke përbushur kështu 13% të këtij Plani.

Tablela 1.2: Disa nga Ligjet e miratuara gjatë sesionit pranveror

LIGJI	SPONZORIZUESI	DATA
Ligji për Byronë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme	Ministria e Drejtësisë	9 Shkurt
Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës	8 Qershor
Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Ministria e Bujqësisë	8 Mars
Ligji për Zhvillim Rajonal	Ministria e Zhvillimit Rajonal	13 Korrik
Ligji për Prokurorin e Shtetit	Ministria e Drejtësisë	20 Prill
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti	Ministria e Financave	27 Korrik
Ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme	Ministria e Arsimit	10 Korrik

Në kuptim të përbushjes së agjendës legjislative, mund të pohohet se Kuvendi nuk ka treguar sukses në përbushjen e saj. Në dokumentin e programit legjislativ të ekzekutivit, për vitin 2023, janë planifikuar të trajtohen 130 projektligje, ndërsa numri që është miratuar përgjatë këtij sesioni, janë vetëm 17. Kësisoj, Kuvendi me vetëm 13% të programit legjislativ të përbushur, nuk paraqet arritje të kënaqshme.

Në çështjen e intenzitetit të punës, Kuvendi i Kosovës, gjatë këtij sesioni është karakterizuar me një dinamikë të luhatshme. Në disa raste, me seanca të shumta brenda një kohe të shkurtër, ndërsa në disa raste tjera me mungesa të seancave për javë tëra. Mungesa e një praktike të punës më të ekuilibruar, përveç që dëmtoi realizueshmërinë e agjendës parlamentare, vështirësoi trajtim të duhur nga ana e deputetëve të pikave të rendit të ditës. Në shumicën e rasteve, seancat planifikoheshin me rende të ditës të ngarkuar dhe kohë të shkurtër për trajtim të projektligjeve, iniciativave apo raporteve shumë të rëndësishme, derisa votimet nuk shoqëroheshin me debate paraprake të domosdoshme.

Në anën tjetër, puna parlamentare gjatë këtij sesioni, në disa raste ka krijuar konsensusin e nevojshëm ndërmjet partisë në pushtet dhe opozitës, në mënyrë që disa nga marrëveshjet që kërkojnë shumicën e dyfishtë të arrijnë të marrin pëlqimin e deputetëve. Ndërsa, në disa raste, si rezultat i mospajtimit të brendshme të partisë në pushtet, projektligje të rëndësishme së veçantë, sikurse Projektligji për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizimin Artificial apo Kodi Civil nuk arritën që të miratoheshin.



Nga këndvështrimi i legjislativitetit të votuar, ka qenë miratimi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili nuk mund të vlerësohet si progres në fushën e zgjedhjeve dhe administrimit të tyre. Ky projektligj, i trajtuar me nguti, ndonëse reflektoi një konsensus të plotë të partive politike parlamentare, në së paku tre pika ka shfaqur ngecje. Fillimisht, zgjerimi i listës preferenciale në 10 kandidatë, pa e mbështetur në një shpjegim të arsyeshëm; lejimi i kandidatëve të dënuar, me vendim të formës së prerë, më pak se tre vite; dhe mundësia që udhëheqësi i Komisionit Qendror Zgjedhor të shkarkohet nga anëtarët me 2/3 e votave, qartazi paraqesin një 'reformim' që bën hapa prapa në procesin e organizimit të zgjedhjeve. Rrjedhshëm, përpjekjeve disa vjeçare për një reformin të njëmend të procesit të zgjedhjeve, Kuvendi duke u kufizuar tek pëlqimet dhe intereset e ngushta të partive politike nuk i'u dha përfundimin e kërkuar.

Mungesat e kuorumit

Një nga problemet që ka ndjekur punën e Kuvendit vazhdueshëm ka qenë mungesa e kuorumit në seanca, si pasojë e mungesave të deputetëve.

Paradoksalisht, nëse shiqohen listat e deputetëve të pranishëm në secilën seancë, ku në listën e pjesëmarrjes figurojnë numra të mjaftueshëm për vendimmarrje, mungesa e kuorumit për votim nuk do të duhej të ishte çështje, lërë më dështimi i seancave në tërësi. Në evidencën e pjesëmarrjes të regjistruar nga Kuvendi, ndonëse ka pasur mungesa të shumta të deputetëve, dëshmohet prani e mjaftueshme e deputetëve, në seancat të cilat janë ndërprerë në mungesë të kuorumit, duke dështuar të përfundohet rendi i ditës. Në çdo seancë në listat e nënshkrimeve janë të evidentuar mesatarisht 90 deputetë, me përjashtim të një seance gjatë muajit prill ku janë evidentuar vetëm 46 deputetë. Kësisoj, në raport me mungesat e deputetëve, një pjesë e problemit qëndron tek deputetët të cilët, megjithëse raportojnë praninë e tyre në seancë, për arsye të ndryshme nuk i bashkohen punimeve të seancës ose në momente të ndryshme dalin nga seanca.

Kjo gjendje ka ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin e agjendës parlamentare dhe si rezultat, Kuvendi është përballur me gjendje të ndërprerjeve të vazhdueshme të seancave për mungesë të kuorumit dhe me pamundësi të votimit sipas planifikimit të punës parlamentare, meqë numri i deputetëve në shumë raste nuk përbushte as shumicën e thjeshtë. Në raste tjera, kur ka pasur shumicë të thjeshtë për miratimin e projektligjeve, nuk ka pasur numra të mjaftueshëm për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për të cilat nevojiteshin 2/3 e votave, dhe kjo ka shkaktuar shtyrjen e votimeve për këto marrëveshjeve të cilat u bartën në seanca, për javë me radhë.

Në këto rrethana, veprimtaria e deputetëve e mbështetur në bindje ideologjike apo opinione për mangësitë e projektligjeve apo marrëveshjeve ndërkombëtare do të ishte e pranueshme, porse refuzimi në heshtje për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit, pa shpjeguar arsyet mbrapa një veprimi të tillë, paraqet mungese të përgjegjshmërisë nga ana e deputetëve.

Se deputetët e kanë obligim pjesëmarrjen në punimet e Kuvendit e ka interpretuar përfundimisht Gjykata Kushtetuese, në rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit lidhur me zgjedhjen e Presidentit i datës 22 shkurt 2011. Aty Gjykata ka theksuar se të gjithë 120 deputetët e Kuvendit duhet të ndjehen të obliguar sipas Kushtetutës, Ligjit për Deputetët, Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të sjelljes të marrin pjesë në seancat plenare të Kuvendit dhe të përkrahin procedurat që parashihen aty, por mbi të gjitha, një obligim vis-a-vis për njerëzit e Kosovës që i zgjedhën ata.¹

Punimet e Kuvendit i ka bojkotuar subjekti politik Lista Serbe që nga viti i kaluar ndërsa deputetët e rinj të kësaj partie gjatë sesionit pranveror kanë ardhur për tu nënshkruar pasi i janë afruar 6 mujorit të mospjesëmarrjes, i cili do të rezultonte me humbje të mandatit. Ngjashëm kanë vepruar edhe dy deputetët tjerë të afërm me këtë subjekt politik, Adem Hodza dhe Fadil Gashi që përfaqësojnë grupet tjera minoritare. Përveç këtyre deputetëve nuk ka deputetë të tjerë të cilët mungesën e tyre e kanë për shkak të bojkotit politik. Ndërsa edhe bojkoti politik si arsye nuk është i justifikueshëm nga legjislativi në fuqi.

Në anën tjetër, listat e regjistrimit të pjesëmarrjes, pasqyrojnë subjektet politike që kanë munguar më së shumti gjatë këtij sesioni. Në përgjithësi 120 deputetët e Kuvendit munguan gjithsej 972 herë në 36 seanca të evidentuara nga ana e Kuvendit. Deputetët që kanë munguar kanë qenë nga pozita dhe opozita, ndërsa si arsye kryesisht janë dhënë udhëtimet e deputetëve apo problemet shëndetësore, por shpesh herë arsyet nuk kanë qenë të ditura.

¹ Shih aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese pika 80 dhe 83 në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_29_11_shq.pdf





Arsyeja pse numri i seancave të mbajtura është më i lartë sesa numri i seancave të evidentuara nga ana e Kuvendit, është sepse Administrata e Kuvendit e regjistron pjesëmarrjen e deputetëve vetëm për një seancë në ditë edhe në rastet kur gjatë një dite mbahen më shumë seanca. Prandaj **numri i mungesave për seancë** është edhe më i lartë.



Një nga problemet më të theksuara të këtij sesioni, ka qenë **përdorimi i gjuhës joparlamentare** dhe të papërshtatshme brenda Kuvendit. Përkitazi me trendet e përkeqësimit tek çështja e gjuhës jo-parlamentare, Kuvendi nuk ka ndërmarrur hapa proporcionalisht me shkeljet.

Arsyeja pse numri i seancave të mbajtura është më i lartë sesa numri i seancave të evidentuara nga ana e Kuvendit, është sepse Administrata e Kuvendit e regjistron pjesëmarrjen e deputetëve vetëm për një seancë në ditë edhe në rastet kur gjatë një dite mbahen më shumë seanca. Prandaj numri i mungesave për seancë është edhe më i lartë.

Kuvendi ka evidentuar pjesëmarrjen e deputetëve në 36 seanca të sesionit pranveror. Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara statistikave se sa herë kanë marrë pjesë deputetët në seanca të kategorizuar sipas grupeve parlamentare. Përveç bojkotit të Listes Serbe, që ka shkaktuar rritjen e numrit të përgjithshëm të mungesave, rritje të trendit të mungesave vërejmë edhe tek partitë tjera parlamentare. Shifra më të larta të mungesave kanë treguar deputetët e partive opozitare. Grupi parlamnetar i LDK-së në raport me numrin e deputetëve ka shënuar gjithsej 122 mungesa në 36 seanca, pasuar nga GP i PDK-së me 129 mungesa, pastaj nga e ai i AAK-së me 52 mungesa. (Tabela 1.3) Më pak mungesa në raport me numrin e deputetëve, gjithsej 188 mungesa, i ka pasur partia në pushtet VV – numër ky i ndikuar ndoshta nga domosdoshmëria për të marrur pjesë në seanca, pasi që numrat për arrijtjen e shumicës së nevojshme për të miratuar ligje kanë qenë mjaft të ngushtë.

Tabela 1.3: Mungesa në seanca sipas Grupeve Parlamentare

GRUPI PARLAMENTAR	PJESMARRJA E PARAPARË NË SEANCA	MUNGESAT	PJESËMARRJA PAS MUNGESAVE	MUNGESAT NË PËRQINDJE
VV	2052	188	1864	9,2%
PDK	648	129	519	19,9%
LDK	576	122	454	21,2%
AAK	288	52	236	18,1%
KOMUNITETET TJERA	288	41	247	14,2%
LISTA SERBE	432	431	1	99,8%
DEPUTETI I PAVARUR – HAKI ABAZI	36	9	27	25,0%
GJITHSEJ:	4320	972	3348	22,5%

Përdorimi i gjuhës jo parlamentare

Një nga problemet më të theksuara të këtij sesioni, ka qenë përdorimi i gjuhës joparlamentare dhe të papërshtatshme brenda Kuvendit. Përkitazi me trendet e përkeqësimit tek çështja e gjuhës jo-parlamentare, Kuvendi nuk ka ndërmarrur hapa proporcionalisht me shkeljet. Rregullorja e Kuvendit të Kosovës i mundëson Kryetarit të Kuvendit të ndërmarrë 5 lloje të masave kundrejt atyre që përdorin gjuhë jo-parlamentare në seancë, siç janë kërkesa për tërheqjen e fjalës, ndërprerja e fjalës, vërejtja, vërejtja me paralajmërim për largim nga seanca plenare dhe përfundimisht largimi nga seanca plenare.² Në raport me gjuhën e përdorur Kryetari nuk ndërmori masat e duhura, shpeshherë duke e toleruar atë. Megjithatë sesioni është karakterizuar nga tema vitale që mund të nxisin tensionim gjatë punimeve parlamentare, përdorimi i gjuhës së papërshtatshme dhe normalizimi i saj, nuk duhet assesi të tingëllojë si e pranueshme. Kjo situatë ka prodhuar fyerje, ofendime edhe sharje të shpeshta, të ardhura nga pothuajse secila parti politike parlamentare. Në rastet më të dalluara, kujtojmë, një rast kur zëvendës-kryeministri Besnik Bislimi, ka përdorur gjuhë seksiste në drejtim të deputetës Ariana Musliu-Shoshi, derisa i shquar ishte edhe rasti i deputetit të LDK, Kujtim Shala, i cili në një seancë ka ofenduar rëndë kryeministrin Kurti.

Mosdënimi i gjuhës së papërshtatshme parlamentare, ka krijuar një perceptim normal të saj brenda Kuvendit, duke rritur tensionet vazhdueshëm brenda Kuvendit. Ky trend i tensionit përveç prodhimit të skenave të papërshtatshme brenda Kuvendit, ka shkaktuar incidentin e rrahjes në grup ndërmjet deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës dhe përfaqësuesve të Vetëvendosjes, anëtar të kabinetit qeveritar dhe deputetë të Kuvendit gjatë muajit korrik. Ky incident ka tejkaluar edhe masat ndëshkuese që parasheh Rregullorja, duke aktivizuar organet e drejtësisë të cilat kanë marrë përsipër rastin në fjalë.

² Rregullore e Punës së Kuvendit të Kosovës, Neni 64, f. 28



Funksioni Mbikqyrës


Një nga funksionet më të rëndësishme të Kuvendit si institucion përkufizohet të jetë roli i tij mbikqyrës. Një koncept qendror si 'mbikqyrja', në rastin e Kuvendit, paraqet një veprimtari të gjerë, e cila fillimisht përfshinë mbikqyrjen që i bënte Ekzekutivit nëpërmjet mekanizmave si pyetjet parlamentare, debatet dhe interpelancat. Përgjatë këtij sesioni, Kuvendi, në formë të ndryshme ka zhvilluar aktivitet mbikqyrës të ekzekutivit. Kryeministri Kurti, është ftuar 3 herë në seanca të veçanta për tema të ndryshme, ashtu sikurse janë ftuar ministrat e ndryshëm. Kryesisht, tema në të cilën Kuvendi ka treguar më tepër vëmendje mbikqyrëse, ka qenë dialogu Kosovë-Serbi – për të cilën ka ftuar kryeministrin Kurti dy herë në seanca të jashtëzakonshme me vetëm këtë temë trajtimi. Një seancë e jashtëzakonshme është mbajtur edhe për ngjarjet pas arrestimit të Drejtorit të Bordit në KEK. Poashtu edhe gjatë seancave të zakonshme plenare, në trajtime e temave jashtë rendit të ditës ose tek pyetjet parlamentare, tema e dialogut me Serbinë dominojë debatin parlamentar.

Një nga instrumentet për kontroll më efektiv parlamentar janë pyetjet parlamentare. **Gjatë këtij sesioni, deputetët ngritën 171 pyetje në drejtim të anëtarëve të ekzekutivit. Disa nga këto pyetje janë ripësëritur disa herë gjatë seancave për shkak të mungesës së ministrave.** Nga një pikëpamje e përgjithshme, numri i pyetjeve që deputetët parashtruan nuk është mjaftueshëm i kënaqshëm – një deputet më pak se një pyetje e gjysmë, paraqet një mesatare të ulët dhe aktiviteti i deputetëve në këtë segment të punës mbikqyrëse parlamentare do të duhej të përmirësohej. Shqetësuese mbetet, mungesa e pyetjeve nga disa deputetë, meqë sipas të dhënave ekzistuese 82 deputetë nuk kanë ngritur asnjë pyetje parlamentare. (Tabela 1.4)

Tabela 1.4: Deputetët që parashtruan më së shumti Pyetje Parlamentare

DEPUTETI/JA	NUMRI I PYETJEVE
Mirlinda Sadiku-Tishukaj	17
Agon Batusha	15
Arjeta Fejza	13
Ganimete Musliu	10
Arijeta Rexhepi	8

Ngjashëm shqetësuese mbeten të dhënat që tregojnë performancë të ulët të partive opozitare në parashtrimin e pyetjeve parlamentare. Me përjashtim të deputetëve të PDK-së, si partia më e madhe opozitare e cila ka ngritur 45 pyetje parlamentare, partitë tjera opozitare kanë treguar aktivitet jo të mjaftueshëm në këtë drejtim. LDK, me 16 deputetë, gjatë gjithë sesionit ka ngritur vetëm 10 pyetje parlamentare, ndërsa AAK me 8 deputetë e saj, ka parashtruar vetëm 13 pyetje. (Tabela 1.5)



Gjatë këtij sesioni, deputetët ngritën 171 pyetje në drejtim të anëtarëve të ekzekutivit. Disa nga këto pyetje janë ripësëritur disa herë gjatë seancave për shkak të mungesës së ministrave.

Tabela 1.5: Pyetjet Parlamentare sipas Grupeve Parlamentare

GRUPI PARLAMENTAR	NUMRI I PYETJEVE	MESATARJA PËR DEPUTET NË RAPORT ME TOTALIN E PYETJEVE
VETËVENDOSJE	102	1,8 pyetje
PDK	45	2,3 pyetje
LDK	10	0,5 pyetje
AAK	13	1,6 pyetje
GRUPI I KOMUNITETEVE	1	0,1 pyetje
LISTA SERBE	0	0 pyetje
GJITHSEJ:	171	

Sa iu përket pyetjeve parlamentare, Kryeministri, ka pranuar 17 pyetje nga deputetët, derisa shumica nga këto ishin pyetje të lidhura me temën e dialogut dhe shqetësime të lidhura me këtë proces. Përgjithshëm, pyetjeve të deputetëve, ndryshe nga Kryeministri Kurti, disa anëtarë të Ekzekutivit nuk i kanë trajtuar seriozisht. Për vlerësim është fakti që i pari i ekzekutivit, Kryeministri Kurti, secilës pyetje i është përgjigjur në rastin e parë, do të thotë në momentin e parashtrimit. Për sjellje të papërgjegjshme në raport me pyetjet e kuvendarëve, duhet të shquhet Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, i cili në disa raste nuk i'u është përgjigjur pyetjeve të deputetëve as pas përsëritjes së shtatë të tyre – duke mos dhënë asnjë përgjigje të kërkuar nga kuvendarët. Në formë të ngjashme, Ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, nuk ka treguar gatishmëri për përgjigje karrshi pyetjeve të deputetëve. Në rastin e Gërvallës, pyetjet janë përsëritur për të pestën herë, derisa nga 10 pyetje që i janë parashtruar ajo është përgjigjur vetëm dy herë, duke treguar qasje jo llogaridhënëse, përballë deputetëve. (Tabela 1.6)



Tabela 1.6: Pyetjet parlamentare dhe përgjigjet e Ekzekutivit

KRYEMINISTRI/MINISTRAT		
EMRI/MBIEMRI	PYETJE PARLAMENTARE	PËRGJIGJIE
ALBIN KURTI	17	17
BESNIK BISLIMI	1	1
ALBULENA HAXHIU	2	1
LIBURN ALIU	48	29
ARBEN VITIA	8	8
FATON PEÇI	3	3
ELBERT KRASNIQI	2	1
FIKRIM DAMKA	1	1
ARTANE RIZVANOLLI	10	10
HEKURAN MURATI	8	6
XHELAL SVEÇLA	13	0
ARBËRIE NAGAVCI	19	14
ROZETA HAJDARI	10	8
DONIKA GËRVALLA	10	2
HAJRULLAH ÇEKU	17	12
ARMEND MEHAJ	2	1
TOTALI:	171	57

Në funksion të mbikëqyrjes, Kuvendi ushtron edhe të drejtën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve të cilat deputetët nëpërmjet Komisioneve vlerësojnë se duhet monitoruar. Edhe në këtë pikë, aktiviteti i Kuvendit të Kosovës ka qenë mjaft i ulët. Kuvendi gjatë këtij sesioni ka mbikëqyrur vetëm dy ligje në tërësi, shifër kjo e pamjaftueshme. Komisioni për Legjislacion, ka mbikëqyrur Ligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe Komisioni për Shëndetësi ka mbikëqyrur për Ligji nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin e plotësimin e ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit. Prandaj, mund të përfundohet që kjo mundësi mbikëqyrjeje nuk është përdorur mjaftueshëm nga ana e deputetëve dhe komisioneve.



SI U TRAJTUA REFORMA NË DREJTËSI?

Fillimi i sesionit pranveror me Ligjin për Byronë?

Gjatë këtij sesioni, Kuvendi shqyrtoi disa projektligje që janë pjesë e reformës në drejtësi krahas projektligjeve tjera. Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme ishte i pari Ligj në kuadër të Reformës që u miratua nga Kuvendi me 9 shkurt 2023, pasi ishte shqyrtuar gjatë gjithë vitit paraprak. Megjithatë, disa ditë pas miratimit, konkretisht me 21 shkurt, ky Ligj u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Që nga ajo kohë Ligji është ende duke u shqyrtuar nga Gjykata e cila ende nuk ka publikuar ndonjë vendim rreth kësaj lënde.

Shqyrtimi nga ana e Kuvendit ishte shoqëruar me mospajtime të thella mes pushtetit dhe opozitës. Subjektet opozitare bojkotuan pjesëmarrjen në grupet punuese dhe Projektligji ishte finalizuar vetëm nga ana e subjektit politik në pushtet. Megjithatë në momentin e votimit nga ana e Kuvendit, Projektligji u përkrah edhe nga ana e Lidhjes Demokratike e cila arsyetoi mbështetjen për faktin që versioni final i Projektligjit ishte vlerësuar pozitivisht nga ana e Komisionit të Venecias, pasi ishte dërguar dy herë atje nga ana e Kryetarit të Kuvendit. Gjatë procesit të shqyrtimit të Projektligjit nga ana e Kuvendit, KDI i kishte ofruar Komisionit për Legjislacion dhe grupit punues respektiv, një hulumtim parlamentar mbi projektligjin dhe rekomandime për adresimin e kërkesave të Komisionit të Venecias dhe rendit kushtetues.³ Kjo analizë u diskutua gjerësisht në një dëgjim publik me akterë nga Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, shoqëria civile dhe përfaqësues ndërkombëtarë.

Konsensusi politik për zhvillimin e Vetingut në Drejtësi

Iniciative tjetër shumë e rëndësishme në kuadër të Reformës në Drejtësi ishte draftimi i procedurave për zhvillimin e vetingut në sektorin e drejtësisë. Pas dorëzimit të dosjes në Kuvend nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në shtator të vitit 2022, në dhjetor Kuvendi krijoi Komisionin Ad-Hoc, i ashtuquajtur Komisioni Ad hoc për hartimin e Projektligjit për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar. Kuvendi i caktoi këtij komisioni mandat 6 muaj me mundësi vazhdimi, për të përgatitur amendamentet kushtetuese dhe një projektligj respektiv për zhvillimin e procesit të vetingut.

Ishte pozitiv fakti që ky komision u krijua me konsensus të gjerë politik dhe përbërja e tij reflektoi subjektet politike nga pozita dhe opozita. Ndërsa, partia opozitare LDK ka marrë udhëheqjen e këtij Komisioni. Takimi i parë i komisionit u mbajt në muajin dhjetor, gjatë të cilit u krijua grupi punues që do të punonte në draftimin e amendamenteve kushtetuese për veting. Efektivisht këto amendamente u draftuan dhe u finalizuan gjatë muajit janar dhe shkurt të sesionit pranveror. Lidhur me këtë, KDI i ka ofruar ekspertizë grupit punues përmes një analize të draft amendamenteve kushtetuese të cilat janë diskutuar në një nga takimet e grupit punues me pjesëmarrës nga Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, shoqëria civile dhe përfaqësues ndërkombëtarë.⁴

³ Analiza e KDI-së "Byroja për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme", tetor 2022, në https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2022/12/Hulumtim_-_Byroja-pe?r-verifikimin-dhe-konfiskimin-e-pasurise?-se?-pajustificueshme.pdf
⁴ Analiza e KDI-së "Analizë rreth projekt amendamenteve kushtetuese për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar/vetingu", shkurt 2023 në, <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/02/01-Raport-Analiza-per-Vetingun-01.pdf>





Sipas procedurës kushtetuese pas finalizimit amendamentet kushtetuese u dërguan në Gjykatën Kushtetuese nga ana e kryetarit të Kuvendit. Ashtu sikurse për Ligjin për Byronë, Gjykata ende nuk ka nxjerrë një vendim as lidhur me amendamentet kushtetuese për Vetingun. Në ndërkohë, Komisionit Ad-Hoc për Veting i ka kaluar mandati 6 mujor dhe pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, komisionit duhet ti shtyhet mandati nga ana e Kuvendit në mënyrë që të mund të punojë në draftimin e Projektligjit për Veting.


Polemikat rreth Ligjit për Këshillin Prokurorial

Një tjetër iniciativë e rëndësishme ligjore që është pjesë e reformës në drejtësi ishte ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ky proces u shoqërua me shumë mospajtime mes pushtetit dhe opozitës por edhe mes Ministrisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Debatu kryesor në Kuvend dhe më gjerë u zhvilluar rreth ndryshimit të numrit të anëtarëve të KPK-së dhe vendimmarrjes në këtë institucion.

Pasi Ligji u miratua nga ana e Kuvendit në qershor të vitit 2022, një muaj më vonë ai u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet opozitare, fillimisht nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe pastaj edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në dy lëndë të ndara, pasi sipas këtyre dy subjekteve ky Ligj e cenonte pavarësinë e gjyqësorit në vend. Lidhur me këtë lëndë Gjykata publikoi aktvendimin rreth një vit më vonë, në mars të vitit 2023, në gjysmë të sesionit pranveror të Kuvendit. Me anë të këtij vendimi Gjykata e shpalli Ligjin të pavlefshëm duke e rikthyer procesin e plotësimit ndryshimit të Ligjit në pikën zero.

Pas vendimit të Kushtetueses, Ministria ka proceduar një tjetër draft të Ligjit në Kuvend dhe për shqyrtimin e tij është krijuar një grup punues në Komisionin për Legjislacion. Tashmë ky Komision ka përfunduar shqyrtimin dhe ka miratuar në parim draftin e ri të Projektligjit. Shqyrtimi i dytë në komision dhe procedimi në seancë të Kuvendit pritet të zhvillohet gjatë sesionit vjeshtor të Kuvendit. Ndërsa dy ditë pas përfundimit të sesionit pranveror Kryetari Glauk Konjufca e ka dërguar këtë Projektligj për vlerësim në Komisionin e Venecias.

Përveç tri iniciativave ligjore të ligjore të lartpërmendura, Kuvendi gjatë këtij sesioni miratoi edhe ligje tjera në kuadër të reformës në drejtësi si Ligjin për Prokurorin e Shtetit, për ekspertët gjyqësor, procedurën përmbartimore, administrative etj. Shqyrtimi i tyre kaloi pa ndonjë debat të gjerë mes partive parlamentare pasi ndryshimet ishin kryesisht të natyrave teknike. Ndërsa, edhe 6 projektligje po ashtu të rëndësishme për reformën kanë mbetur në procedurë për sesionin vjeshtor, si ndryshimet në kodin penal, në kodin e procedurës penale, prokurorinë speciale etj.



Kuvendi shqyrtoi disa projektligje që janë pjesë e reformës në drejtësi krahas projektligjeve tjera. Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme ishte i pari Ligj në kuadër të Reformës që u miratua nga Kuvendi me 9 shkurt 2023.



ZHVILLIMET NË KOMISIONE

Përgjatë sesionit pranveror, 14 komisionet e Kuvendit zhvilluan gjithsej 221 mbledhje, 10 dëgjime publike dhe 5 vizita në terren. Komisionet me numrin më të madh të mbledhjeve me mbi 20 mbledhje gjatë kësaj periudhe janë, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me 24 mbledhje dhe 3 dëgjime publike, më pas Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me 22 mbledhje dhe 2 dëgjime publike. Pothuajse ngjashëm renditet edhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere me 23 mbledhje të mbajtura gjatë këtij sesioni. 20 mbledhje i ka mbajtur Komisioni për Legjislacion, ndërsa nën 20 mbledhje janë të gjitha komisionet tjera parlamentare. Më së paku mbledhje gjatë sesionit, vetëm 7 të tilla, i ka zhvilluar Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë.

Gjatë këtij sesioni Komisionet trajtuan rreth 35 projektligje. Të gjitha këto projektligje u trajtuan nga 4 komisionet e përhershme, ndërsa më pak të angazhuara në këtë aspekt ishin komisionet tjera funksionale, të cilat trajtuan vetëm projektligjet që bien në fushëveprimitarinë e tyre. Sa i përket mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, para komisioneve parlamentare paraqitën projektligje dhe raportuan 35 herë ministrat e Qeverisë, ndërsa 42 herë përfaqësuesit e tjetër të lartë institucional. Gjatë kësaj periudhe vetëm tri nga komisionet zhvilluan vizita në terren tek insitucionet përkatëse. Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve, Komisionet draftuan vetëm 2 raporte të monitorimit, atë për Ligjin për Ndërmejtësim dhe Ligjin për Kontrollin e Duhanit. Ndërsa, zhvilluan diskutime në mbledhje apo aktivitete mbikëqyrëse të zbatimit edhe të 5 Ligjeve tjera. Më poshtë janë të paraqitura detajet e aktiviteteve për secilin komision.

✓ Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere gjatë sesionit pranveror ka mbajtur gjithsej 23 mbledhje. Meqë edhe ky komision është një nga komisionet e përhershme gjatë këtij sesioni ka pasur agjendë të stërngarkuar ku sipas mandatit ka shqyrtuar 35 projektligje, mes tyre edhe 3 marrëveshje ndërkombëtare.

Temat kryesore që ka mbuluar legjislacioni i shqyrtuar nga ky komision janë nga fusha të ndryshme si buxheti, byroja shtetërore, siguria e produkteve, pyjet, energjia, prokurori i shtetit, ndërtimet pa leje, mjekësia ligjore, prona publike, verërat etj.

Përveç projektligjeve komisioni ka shqyrtuar edhe 10 raporte të institucioneve dhe agjencive shtetërore. Ndërsa, sa i përket raportimeve të ekzekutivit, para komisionit ka qenë prezent 7 herë Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati i cili ka paraqitur projektligje dhe marrëveshje ndërkombëtare. Në 11 raste kanë raportuar zyrtarë tjerë shtetëror si Auditorja e Përgjithshme, përfaqësues të Agjencisë për Privatizim, drejtori i TRUST-it, bordi i RTK-së, bordi i Fondit të Kursimeve Pensionale, i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, etj.

Çështja kryesore që ka karakterizuar disa nga mbledhjet e këtij komisioni ka qenë shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës për shkarkimin nga pozita të anëtares së OSHP-së, Kimete Gashi. Për këtë çështje komisioni ka diskutuar në tri mbledhje dhe në fund nuk ka arritur të miratojë këtë vendim të Qeverisë.

✓ Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Si një nga komisionet e përhershme, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim pati mjaft punë në shqyrtimin e të gjitha projektligjeve që erdhën para këtij komisioni për ti trajtuar nga aspekti i të drejtave të





komuniteteve. Kështu gjatë këtij sesioni, në 11 mbledhje të mbajtura ky komision shqyrtoi gjithsej 30 projektligje. Një nga problematikat kryesore që e shoqëroi punën e komisionit, ishte bojkoti politik i anëtarëve të Listës serbe, të cilët pasi bojkotuan punën e përgjithshme në Kuvend, pushuan edhe pjesëmarrjen në punimet e komisioneve ku ishin anëtarë. Si rrjedhojë, nga 18 anëtarë sa ka pasur ky komision, tash e disa muaj ka vetëm 12 anëtarë, ndërsa pjesëmarrje aktive kanë vetëm 10 anëtarë. Kjo sepse edhe 2 anëtarë tjerë deputetë që nuk janë zyrtarisht pjesë e Listës Serbe, siç është deputeti i Partisë Unike Gorane Adem Hodza, dhe deputeti i Romani Iniciativa Fadil Gashi, po ashtu kanë bojkotuar Kuvendin, njëherit edhe këtë komision.

✓ Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Gjatë sesionit pranveror, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit mbajti gjithsej 20 mbledhje.

Meqë është një nga komisionet e përhershme ky Komision pati agjendë të ngarkuar duke shqyrtuar 33 projektligje dhe raporte të komisioneve tjera nga fusha të ndryshme veçanërisht të reformës në drejtësi por edhe fusha tjera si pyjet, buxheti, ndërtimet pa leje, kinematografia, mbrojtja e konsumatorit etj. Dinamika e komisionit u karakterizua kryesisht me diskutime për përputhjen e legjislacionit me ligjet tjera ekzistuese dhe aspektin kushtetues.

E ftuar në komision ishte dy here Ministria e Drejtësisë Albulena Haxhiu. Një herë për të paraqitur dhe arsyetuar dy Projektligje, atë për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze. Ky projektligj u miratua në parim. Si dhe Projektligjin për përfaqësimin e institucioneve shtetërore në procedura gjyqësore dhe arbitrazh. Herën e dytë ministria paraqiti dhe arsyetoi Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Përveç ministres para komisionit raportuan nga një herë edhe drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj si dhe kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi për punën e këtyre institucioneve për vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe ky komision miratoi edhe raportin e monitorimit të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim.

✓ Komisioni për Integritet Evropiane

Gjatë këtij sesioni, Komisioni për Integritet Evropiane ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje gjatë të cilave ka shqyrtuar 30 projektligje kryesisht nga aspekti i përputhjes me legjislacionin e BE-së. Projektligjet e trajtuara ishin për fusha si mbrojtja e konsumatorit, energjia, edukimi në fëmijërinë e hershme dhe fusha tjera. Po ashtu u trajtuan edhe projektligjet e reformës në drejtësi si kodin penal, kodi i procedurës penale, mjekësia ligjore, ekspertët gjyqësor etj. Komisioni po ashtu shqyrtoi edhe një marrëveshje financiare IPA mes Kosovës dhe BE-së.

Sa i përket mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, para komisionit raportuan 3 ministra, Zëvendës kryeministri i parë për integritet evropian, zhvillim dhe dialog, Besnik Bislimi, Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe Ministria e Drejtësisë Albulena Haxhiu. Të tre përfaqësuesit ekzekutiv raportuan kryesisht për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga agjenda evropiane të dikastereve përkatëse.

✓ Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, është një nga komisionet që zhvilloi pak mbledhje gjatë këtij sesion, me vetëm 7 mbledhje gjithsej. Zhvillimet kryesore në këtë komision gjatë kësaj periudhe ishin dy raportime. Konkretisht ai i Zëvendës kryeministri i parë për integritet evropian, zhvillim dhe dialog, Besnik Bislimi, i cili raportoi për dialogun Kosovë-Serbi dhe raportimi i Ministres së Punëve të Jashtme Donika Gërvalla, e cila lidhur me punën e kësaj ministrie. Të dy këto raportime prodhuan debat të ashpër mes anëtarëve të komisionit nga pozita dhe opozita.

Në aspektin e udhëheqjes së komisionit, kishte ndryshim të kryetarit të komisionit për shkak të zhvillimeve politike brenda subjektit politik në pushtet LVV, ku kryetari Haki Abazi u shkarkua nga kjo pozitë dhe u zëvendësua me deputeten Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, e cila kryesoi komisionin nga fundi i muajit shkurt e tutje. Ndër të tjera, ky komision gjatë sesionit, shqyrtoi edhe 1 projektligj, atë për buxhetin e shtetit si dhe diskutoi lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

✓ Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport gjatë këtij sesioni mbajti gjithsej 13 mbledhje dhe 2 dëgjime publike. Gjatë mbledhjeve të mbajtura u shqyrtuan gjithsej 10 projektligje të fushave të ndryshme si arsimit i lartë, kinematografia, edukimi në fëmijërinë e hershme, të drejtat e autorit, arsimit dhe kultura etj. Ndërsa 2 dëgjime publike u mbajtën për projektligjin për kinematografi dhe një për projektligjin për të drejtat e autorit. Komisioni shqyrtoi edhe 1 raport vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Para komisionit për të paraqitur projektligje që bien mbi fushë veprimtarinë e këtij komisioni ishte 3 herë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci ndërsa homologu i saj Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku ishte prezent 2 herë në këtë komision. Në një nga mbledhjet raportoi edhe zëvendës ministria e kësaj ministrie.

Vlen të theksohet që ky komision ka pasur për mandat të shqyrtojë edhe dy marrëveshje ndërkombëtare që burojnë nga procesi i Berlinit, konkretisht Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor si dhe Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve profesionale të mjekëve, dentistëve, arkitektëve në Ballkanin Perëndimor, të cilat më pas janë miratuar në seancë të Kuvendit. Përveç mbledhjeve të rregullta anëtarët e këtij komisioni gjatë kësaj periudhe zhvilluan edhe dy vizita në terren. E para u realizua në Olimpiadën Speciale të Kosovës, të cilës i ofruan mbështetjen e Komisionit në ngritjen e kapaciteteve. Ndërsa vizita e dytë, u zhvillua në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit Ligjit për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

✓ Komisioni për Ekonomi dhe Ndërmarrësi

Komisioni për Ekonomi dhe Ndërmarrësi gjatë këtij sesioni pranveror mbajti gjithsej 24 mbledhje dhe 3 dëgjime publike. Për rreth shtatë muaj sa zgjati sesioni, komisioni në fjalë shqyrtoi gjithsej 6 projektligje për tema si energjia, investimet e qëndrueshme, minierat dhe mineralet, mbrojtja e konsumatorit etj. Po ashtu u shqyrtuan edhe 14 raporte të institucioneve dhe agjencive si dhe dy vendime të Qeverisë. Para komisionit raportuan ministra e zyrtarë të lartë institucional. Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli raportoi 5 herë para këtij komisioni qoftë për të paraqitur projektligje apo për të prezantuar raportet e performancës së kësaj ministrie. Ngjashëm, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Rozeta Hajdari ishte dy herë para komisionit, ndërsa mungoi në një rast kur ishte e ftuar nga ky komision. Në anën tjetër, 14 herë raportuan për punën e tyre përfaqësues të bordeve të kompanive si Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) etj.

Diskutimet kryesore në këtë komision u zhvilluan rreth çështjes së energjisë dhe ndërmarrjes Ferronikeli. Për këtë të fundit komisioni rekomandoi shkarkimin e anëtarëve të Bordit të KPM-së, në mënyrë individuale, si dhe anulimin e vendimit mbi lirim dhe obligimit të rentës minerare të ndërmarrjes "Ferronikeli". Gjatë kësaj periudhe ky komision miratoi edhe raportin për mbikëqyrjen e Ligjit për komunikime elektronike.

✓ Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim Dhe Zhvillim

Gjatë kësaj periudhe, Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim Dhe Zhvillim ka zhvilluar gjithsej 15 mbledhje. Diskutimet kishin në fokus shqyrtimin e 9 projektligjeve që bien në fushëveprimin e këtij komisioni si Projektligji për pyje, verëra, organizimin e tregut bujqësor, ndërtimet pa leje, vlerësimin strategjik mjedisor etj. Përveç tyre, u trajtua



edhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" për të cilin u organizua një dëgjim publik dhe po ashtu u ftua në raportim edhe Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu. Një dëgjim tjetër publik komisioni e mbajti për projektligjin për verëra.

Komisioni gjatë kësaj periudhe pranoi edhe dy peticione nga qytetarët rreth parkingjeve publike, për të cilat komisioni u dakordua që të mbledhin disa të dhëna nga komunat dhe me pas të mbahet një tryezë e rrumbullakët. Një tryezë e tillë nuk u organizua gjatë këtij sesioni.

✓ Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, gjatë këtij sesioni mbajti 22 mbledhje gjatë të cilave shqyrtoi 6 projektligje në fusha si shëndeti riprodhues dhe fertilizimi i asistuar mjekësor, çmimi i produkteve medicinale, sëmundjet ngjitëse, lista esenciale e barnave, buxheti i shtetit e skemat penzionale. Përveç kësaj, komisioni mbajti edhe dy dëgjime publike për dy nga projektligjet e lartpërmendura. Në aspektin e mbikëqyrjes, u zhvilluan raportime të 2 ministrave, konkretisht Ministri i Shëndetësisë Arben Vitia raportoi 2 herë para komisionit, ndërsa Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati, raportoi 2 herë.

Komisioni i dedikoi një pjesë të aktivitetit edhe monitorimit të ligjeve ku gjatë kësaj periudhe monitoroi Ligjin për kontrollin e Duhanit. Ndërsa, zhvilloi edhe një vizitë në terren, në Klinikën e Neurokirurgjisë në QKUK.

✓ Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal gjatë sesionit pranveror mbajti gjithsej 17 mbledhje. Ky komision nuk pati agjendë të ngarkuar të punës ndërsa, diskutimet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe kanë përfshirë shqyrtimin e 6 projektligjeve për fusha si buxheti i shtetit, agjencitë ekzekutive, procedurat e veçanta administrative, zhvillimi rajonal i balancuar, zyrtarët publik etj.

Përveç projektligjeve në fjalë, komisioni ka shqyrtuar edhe tri raporte institucionale të performancës, atë të RTK-së, Komisionit të Pavarur për Media dhe të Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, të cilat u shpalosën nga përfaqësuesit respektiv. Në komision për të paraqitur projektligje ishin edhe Ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka si dhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme ndërsa raportoi në një rast edhe Komisioni i Pavarur i Mediave. Vlen të theksohet se përveç temave të lartpërmendura që ky komision i ka trajtuar në bazë të fushë veprimtarisë së tij, ka zhvilluar edhe një seancë dëgjimore me gazetarët e lënduar gjatë raportimit të ngjarjeve nga veriu.

✓ Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, gjatë këtij sesioni ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje gjatë të cilave ka shqyrtuar çështje të cilat bien në fushë veprimtarinë e këtij komisioni. Në përgjithësi, ky komision ka trajtuar 4 projektligje në fusha si informacioni i klasifikuar, inteligjenca, buxheti dhe regjistrimi civil. Po ashtu ka shqyrtuar dhe mbështetur një marrëveshje ndërkombëtare që derivon nga Procesi i Berlinit, konkretisht marrëveshja për Lëvizjen e Lirë me Letërnjoftim në Ballkanin Perëndimor. Tema kryesore që mbizotëroi diskutimet në këtë komision ishin zhvillimet në veri sidomos pas përkeqësimit të gjendjes atje në pjesën e dytë të sesionit.

Sa i përket mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, u shqyrtuan dy raporte të performancës, ndërsa para komisionit raportuan përfaqësues të institucioneve si Drejtori i Policisë, kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, Komisionerja e Agjencisë për Informim dhe Privatësi etj.



✓ Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, është një nga komisionet që ka pasur aktivitet më të shumëllojshëm gjatë këtij sesioni. Nga totali i 20 mbledhjeve sa ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe ky komision ka shqyrtuar gjithsej 5 projektligje për çështje si personat e pagjetur, mbrojtja nga diskriminimi, liritë fetare, dhuna në familje etj. Si dhe 1 marrëveshje ndërkombëtare për Statusin dhe Funksionet e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur. Për këtë të fundi ka organizuar edhe një dëgjim publik me akterë institucional dhe të shoqërisë civile. Përveç kësaj komisioni zhvilloi edhe një tryezë diskutimi lidhur me mundësinë e përfshirjes së Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Temat që mbizotëruan diskutimet në këtë komision ishin rreth mbrojtjes së të drejtave të njeriut ashtu siç është edhe fushëveprimi i këtij komisioni me fokus tek të pagjeturit, personat me aftësi të kufizuara, komunitet jo shumicë etj. Në ushtrimin e mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, komisioni pati të ftuar në raportim nga 2 herë kryetarin e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur, Andin Hoti, Avokatin e Popullit Naim Qelaj dhe anëtarët e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës.

Vlen të theksohet se ky komision zhvilloi më së shumti vizita në terren ku gjatë kësaj periudhe pati gjithsej 5 vizita të tilla në institucione si burgjet në Lipjan dhe Prizren, Qendrën Integruese Rehabilituese të të Sëmuarve Kronikë Psikiatrikë në Shtime si dhe Repartin e Neonatologjisë dhe Repartin e Gjinekologjisë në kuadër të SHSKUK-së.

✓ Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë këtij sesioni ka mbajtur gjithsej 19 mbledhje gjatë të cilave ka shqyrtuar vetëm një projektligj atë për buxhetin shtetëror. Ndërsa, ky komision në bazë të fushë veprimtarisë së tij ushtroi mbikëqyrjen e financave publike përmes shqyrtimit të raporteve të auditimit. Kështu gjatë kësaj periudhe shqyrtoi gjithsej 17 raporte të tilla të institucioneve të ndryshme duke filluar nga ndërmarrja Trepça, komunat, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike (KOSTT), Agjencia e Regjistrimit Civil, Këshilli Prokurorial, Zyra Kombëtare e Auditimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit etj.

Për të prezantuar këto raporte para komisionit raportuan përfaqësuesit e këtyre institucioneve duke përfshirë edhe 5 ministra, Ministri i Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe Ministri Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Ky i fundit e ka lëshuar mbledhjen në shenjë pakënaqësie me pyetjet që sipas tij iu kishin parashtruar rendit të ditës.

✓ Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, si një nga komisionet më specifike për kah fushë veprimtaria, mbajti diskutimet kryesore prapa dyerve të mbyllura. Megjithatë nga të dhënat publike rezultoi që ky komision gjatë periudhës së trajtuar ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje ku ka shqyrtuar një projektligj, atë për buxhetin e shtetit. Diskutimet janë mbajtur kryesisht në formatin e raportimeve ku para komisionit ka raportuar 2 herë drejtori i drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajeti dhe 2 herë Inspektori i Përgjithshëm i kësaj Agjencie Kujtim Shala. Detajet e këtyre diskutimeve nuk janë bërë publike mirëpo raportimet janë zhvilluar kryesisht gjatë përkeqësimit të situatës së sigurisë në vend, konkretisht në pjesën veriore.





HAPA MBRAPA NË TRANSPARENCË

Në bazë të të dhënave nga monitorimi i Kuvendit gjatë këtij sesioni, mund të pohohet se Kuvendi ka bërë hapa prapa në fushën e transparencës. Praktikën e aplikuar gjatë këtij sesioni e kanë dëmtuar transparencën rëndë. Ndër tjera, mos arritja të zgjidhin problemin me votimin elektronik që ka krijuar shumë paqartësi në lidhje me votimin, mos ofrimin e të dhënave për votimin e deputetëve dhe praktikën e mos ofrimit të të dhënave në lidhje punën e komisioneve, paraqesin zhvillime negative në fushën e transparencës së Kuvendit.

Mungesa e votimit elektronik, nëpërmjet të cilit bëhet i ditur numri dhe votimi i individual i deputetëve, ka lënduar procesin e transparencës. Ndërsa qasja e Kuvendit në raport me këtë çështje vetëm se e ka përkeqësuar gjendjen, meqëneqë Kuvendi përveç që nuk ka përsheptuar procesin e pajisjes me mjetet për votimin elektronik, ai edhe nuk ka publikuar të dhëna rreth votimit të deputetëve individuale, duke lënë vullnetin e deputetëve të pa njohur për qytetarët. Një praktikë e tillë e Kuvendit paraqet një mënyrë që bie në kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit – më saktësisht, Nenit 61, paragrafi 9 të Rregullores, i cili parashihet se “Publikimi i votimit me dorë bëhet publike brenda dy (2) ditë pune pas përfundimit të votimit në seancë plenare”.

Ndërsa, tek tema e transparencës dhe informimit për aktivitetet e tyre, mirë nuk qëndrojnë as komisionet e Kuvendit. Në seksionin për publikimin e të dhënave të aktiviteteve të tyre, disa prej tyre i'u mungojnë edhe të dhënat mbi mbledhjet e mbajtura, ndërsa në shumë raste mungojnë të dhënat bazike për mbledhjet e mbajtura, sikurse procesverbali. Për tu kritikuar është edhe mungesa e dokumenteve sikurse raporti për punën e sesionit në tërësi apo plani i punës. Praktika e ngjashme e mosraportimit të aktiviteteve të Komisioneve është vërejtur edhe tek Komisionet Ad-Hoc, puna e të cilave nuk pasqyrohet fare brenda uebfaqës zyrtare të Kuvendit.



Ndër tjera, mos arritja të zgjidhin problemin me **votimin elektronik** që ka krijuar shumë paqartësi në lidhje me **votimin**, mos ofrimin e të dhënave për **votimin e deputetëve** dhe praktikën e mos ofrimit të të dhënave në lidhje punën e komisioneve, paraqesin zhvillime negative në fushën e **transparencës së Kuvendit**.



Tabela 1.7: Procesverbalet e publikuara nga Komisionet parlamentare në raport me numrin e mbledhjeve të sesionit pranveror

KOMISIONI	NUMRI I MBLEDHJEVE	NUMRI I PROCESVERBALEVE TË PUBLIKUARA
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere	23	9
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim	11	9
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	20	10
Komisioni për Integrim Eropian	12	12
Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë	7	7
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport	13	6
Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti	24	21
Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim	15	14
Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	22	17
Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal	17	12
Komision për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes	9	0
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione	20	16
Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	19	13
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	9	0





PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Në përgjithësi, ky sesion pranveror i Kuvendit ka shpërfaqur pothuajse të gjitha mangësitë e zakonshme të punës së Kuvendit që kanë karakterizuar edhe sesionet e kaluara. Madje, në disa nga mangësitë, ka pasur edhe trende përqendrimi. Planifikimi i punës parlamentare dhe realizimi i agjendës parlamentare kanë qaluar si çdoherë, me agjendë të ngarkuar dhe të paplanifikuar mirë në pikëpamje të shtrirjes së mirëfilltë të aktivitetit dhe realizueshmërisë.

Kuvendi gjatë këtij sesioni në 49 seanca, miratoi gjithsej 44 projektligje duke përbushur 13% agjenden legjislative të Qeverisë 2023. Ndërsa gjatë kësaj periudhe, u mbajtën 221 mbledhje të komisioneve parlamentare.

Funksioni mbikëqyrës i Kuvendi të disa raste u penalizua nga mos gatishmëria e ekzekutivit për të ofruar transparencë dhe llogaridhënie ndaj deputetëve dhe publikut. Kështu shumë pyetje parlamentare të deputetëve ngelën pa përgjigje ndonëse u përsëritën në disa seanca me rradhë. Në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjeve, deputetët raportuan për zbatimin e vetëm dy Ligjeve.

Fenomeni i mungesave të deputetëve ka vazhduar, në shumë raste edhe më tepër se siç paraqitet në evidencat zyrtare të Kuvendit, me deputetë të cilët janë regjistruar por më pas nuk kanë marrë pjesë në punimet e Kuvendit. Kjo në shumë raste ka shkaktuar mungesë të kuroumit duke bërë që disa seanca të mos mbahen fare apo të ndërpriten për shkak të prezencës së pamjaftueshme të deputetëve.

Sjellje të pa përshtatshme të deputetëve si gjuha jo parlamentare ishte e evidente në disa raste e cila kaloi pa u ndëshkuar, ndënjëse Rregullorja e Kuvendit parasheh masa për sjellje të tilla. Për më tepër, në muajin e fundit të sesionit klima e ashpër e përplasjes politike që ishte krijuar që nga fillimi i sesionit eskaloj në dhunë fizike, që përfshiu deputetë e ministra në përmasa të pa dëshmuara ndonjëherë në Kuvendin e Kosovës.

Edhe këtë sesion vazhdoi bojkoti politik i Listës Serbe për shkak të zhvillimeve në pjesën veriore të vendit, të cilët morën pjesë vetëm një herë në seanca gjatë këtij sesioni për të ripërtirë mandatet pas 6 muajve mungesa, që sipas Rregullores pason me humbje të mandatit të deputetit.

Duke u bazuar në zhvillimet gjatë këtij sesioni por jo vetëm, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme për Kuvendin në përgjithësi dhe deputetët në veçanti:

- **Planifikimi i mirëfilltë i seancave:** Kuvendi duhet sa më parë të organizojë punën parlamentare në mënyrë të mirëfilltë qoftë përmes një kalendari mujor apo praktikave tjera të mira që mundësojnë mbarëvajtjen e organizimit të punës parlamentare. Planifikimi ekzistues me disa seanca në periudhë të ngushtë kohore, me një rend ditë të ngarkuar, duhet të braktiset si praktikë. Në të kundërtën, një shtrirje e duhur e seancave në kalendar, pa mungesë të seancave për disa javë, por me seanca të përjavshme dhe me rreze ditë të pa ngarkuar do të mundëson trajtimin më të mirëfilltë të materialit që deputetët trajtojnë.
- **Mungesa e kuorumit dhe prezenca në letër:** Kuvendi duhet të trajtojë me seriozitet çështjen e mungesave të deputetëve. Veçanërisht për seancat në të cilat, sipas evidencës zyrtare, ka numër të mjaftueshëm të deputetëve për zhvillim të punës parlamentare, por që dështojnë në praktikë. Kuvendi duhet të kujdeset që kjo shpërputhje në mes të pjesëmarrjes reale të deputetëve në seanca dhe listave zyrtare të regjistrimit të mos ekzistojë. Po ashtu Kuvendi duhet të fillojë praktikën e regjistrimit të mungesave për çdo seancë në rastet kur ka më shumë se një seancë gjatë ditës.



- **Konsensusi dhe gjithpërfshirja për Reformën në Drejtësi:** Konsensusi i gjerë politik i arritur për shqyrtimin e procesit të Vetingut duhet të vazhdojë edhe gjatë sesioneve të ardhshme. Pas vlerësimit të draft amandamenteve Kushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese, barra kryesore do t'i kalojë partisë në pushtet për të mirëmbajtur konsensusin aktual dhe për të zgjeruar mbështetjen edhe tek partitë e komuniteteve jo shumicë. Kjo duke pasur parasysh që votimi i amandamenteve kushtetuese kërkon 2/3 edhe të këtyre subjekteve. Po ashtu, gjatë shqyrtimit të Projektligjeve që bien në kuadër të Reformës duhet të organizohen më shumë dëgjime publike, me qëllim garantimin e gjithpërfshirjes në këtë proces.
- **Mbikqyrja ndaj ekzekutivit:** Në përmbushjen e funksionit mbikëqyrës, deputetët e Kuvendit duhet të jenë më aktiv në garantimin e llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit duke parashtruar më shumë pyetje parlamentare. Subjektet parlamentare deri më tani kanë treguar performancë jo të kënaqshme në këtë drejtim, me vetëm 171 pyetje të parashtruara ndaj ekzekutivit gjatë gjithë sesionit dhe me 82 deputetë, të cilët nuk kanë ngritur asnjë pyetje. Deputetët, individualisht duhet të shfrytëzojnë këtë të drejtë, pa dallim se cilit subjekt i takojnë, veçanërisht për çështje që prekin mirëqenien e qytetarëve.
- **Mbikqyrja e zbatimit të Ligjeve:** Kuvendi duhet të shënojë përmirësime edhe në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Statistikat e këtij sesioni tregojnë për numër të vogël të Ligjeve që Kuvendi ka mbikëqyruar, duke shtruar nevojën që në sesionet e ardhme kjo çështje të adresohet.
- **Adresimi i gjuhës jo parlamentare:** Kuvendi duhet të sfidojë fenomenin e gjuhës joparlamentare e cila po vazhdon të evidentohet në seanca dhe komisione parlamentare. Praktika e përdorimit të një gjuhe të papërshtatshme, ofenduese dhe linçuese janë shndërruar në situata normale. Në pikëpamjen tonë, kësaj i ka ndihmuar edhe mënyra se si Kuvendi i'u është qasur problemit dhe formës se si është lexuar Rregullorja e Kuvendit. Përballë kësaj praktike, Kuvendi duhet të ndërmarrë hapa sa më të shpejtë, fillimisht me një qasje më strikte të interpretimit të Rregullores, duke bërë të mundur ndëshkimin e deputetëve që përdorin gjuhë të tillë.
- **Përplasjet fizike:** Përplasjet politike të shëndërruara në përplasje fizike janë të parpanueshme për institucionin e Kuvendit. Skena të papranueshme të dhunës gjatë muajit korrik nuk duhet të përsëriten më. Dhuna, asnjëherë, përballë çfarëdo situatë nuk mund të jetë mjet politik dhe në asnjë kontekst nuk mund të përligjet.
- **Transparenca:** Kuvendi duhet të përmirësojë aspektin e transparencës ndaj publikut. Në mënyrë që të rritet transparenta dhe llogaridhënia e Kuvendit dhe e deputetëve individualisht, Kuvendi duhet që në një afat sa më të shpejtë të mundshëm ta rikthejë votimin elektronik. Në ndërkohë, Kuvendi përveç publikimit të votave kumulative, duhet të bëjë të qasshme për publikun rezultatet e votimit me dorë për secilin deputet individualisht në seancat e Kuvendit. Në anën tjetër, trupat tjerë të Kuvendit duhet të bëjnë publike në mënyrë të rregullt edhe dokumentet tjera siç janë procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare, duke përfshirë edhe të Komisioneve Ad-Hoc.



